



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/09-39458/24, më 20 MAR 2024

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 shkronja (n) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe Plotësohet Vendimi për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016 si dhe Vendimi me nr.14.030/01-21504/24 i dt.08.02.2024 me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar Vendimi për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, plotësim ndryshimi nënkupton ndryshimin e nenit 1, paragrafi 1.1 të Vendimit me nr.14.030/01-21504/24 i dt.08.02.2024 dhe nenit 25, paragrafit 1.2 të Vendimit me nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016, respektivisht bartjen e Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Larta nga Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave në Drejtorinë për Transformim të Kryeqytetit.
- III. Sipas pikës I dhe II të këtij Vendimi, Drejtoria për Transformim e Kryeqytetit, ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 1. Harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm për të gjitha investimet kapitale që konsiderohen Ndërtim i Lartë dhe krahas përpilon strategjinë për menaxhimin e kontratave në nivel të komunës. Programi i hartuar përfshinë dhe merr parasysh nevojat zhvillimore të drejtorive të komunës, kërkesat e banorëve dhe të bashkësive lokale, kërkesat e organizatave, institucioneve dhe të gjithë pjesëmarrësve në jetën dhe funksionin e Kryeqytetit, dhe propozon mënyrën e realizimit të tij. Programi duhet të jetë në harmoni me planet zhvillimore dhe rregulluese të qytetit dhe komunës në përgjithësi,

si dhe në pajtim me agjendën e Programit dhe Strategjisë Zhvillimore të Kryetarit të Kryeqytetit;

2. Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të ndërtimeve të komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit, me pikësnyim zhvillimin e ndërtimit me standardet të BE-së;

3. Në koordinim dhe kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e Komunës sipas programeve të tyre zhvillimore e strategjike inicion programet projektuese (detyrat projektuese) për përgatitjen e Dokumentacioneve Teknike (DT) investuese të mundshme dhe të planifikuara;

4. Udhëzon dhe ndihmon Operatorët Ekonomik (OE) të specializuar në fushat e fizibilitetit (lëvërdishmërisë), projektimit, planifikimit dhe këshillimeve të tjera që nevojiten, në zhvillimin e programeve projektuese (detyrat projektuese) për përgatitjen e Dokumentacioneve Teknike (DT) investuese të projekteve të planifikuara sipas standardeve të aprovuara në BE;

5. Udhëzon dhe ndihmon OE të specializuar për marrjen dhe pajisjen me kushte, pëlqim dhe leje të duhura si Komunale ashtu dhe për ato të shërbimeve përcjellëse të domosdoshme për nisjen e realizimit të projekteve;

6. Mbështet zyrën e prokurimit në vlerësime dhe raportime gjegjëse në procesin e prokurimit për OE të specializuara në realizimin-ndërtimin e projekteve;

7. Ben menaxhimin e projekteve duke i përcjellë me mbikëqyrje financiare, kohore dhe të cilësisë së punëve, materialeve dhe pajisjeve të OE në procesin e realizimit -ndërtimit sipas standardeve të BE-së deri në përmbylljen e projekteve - kur bëhet kontrollimi final inspektues dhe dorëzimi përdoruesve të tyre;

8. Këshillon Kryetarin dhe Drejtorinë tjera të komunës për investime kapitale të Ndërtimit të Lartë;

9. Kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të Drejtorisë;

10. Ruan dokumentacionin e eksproprijimit të pronave, për vitet e mëhershme, në interes të Komunës;

11. Arkivon dokumentacionin e Drejtorisë së Transformimit të Kryeqytetit.

12. Kryen edhe punë tjera që janë në interes të komunës.

IV. Sipas nenit III të këtij Vendimi, me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozita ligjore në fuqi, Drejtoria e Transformimit të Kryeqytetit, është e organizuar në këta sektorë:

13. Sektori i planifikimit të projekteve investuese,
14. Sektori i menaxhimit të kontratave,
15. Sektori i shërbimeve të përgjithshme.

1. Sektori i planifikimit të projekteve

Fushë veprimtaria e Sektorit:

- Asiston në hartimin e planeve dhe programeve zhvillimore afatmesme, vjetore ose edhe mujore për drejtorinë;
- Harton planet dhe programet zhvillimore afatmesme, vjetore ose edhe mujore për Sektorin;
- Përcjell, hulumton dhe asiston në përpilimin e planeve dhe programeve zhvillimore që hartohen prej drejtorive të Komunës në lidhje me projektet e mundshme të Ndërtimit të Larte, nga aspekti i njohurive teknike dhe të përpilimit sa më të saktë të buxheteve për ato;
- Në koordinim dhe kontakt të vazhdueshëm me Drejtoritë e Komunës sipas planeve dhe programeve të tyre zhvillimore dhe strategjike inicion programet projektuese (detyrat projektuese) për përgatitjen e Dokumentacioneve Teknike (DT) investuese të mundshme dhe të planifikuara;
- Mbikëqyrë hartimin e projekteve për investime të komunës, konsultohet me drejtoritë dhe komunitetin për projekte të reja;
- Udhëzon dhe ndihmon Operatoret Ekonomik (OE) të specializuar në fushat e fizibilitetit (lëvërdishmërisë), projektimit, planifikimit dhe këshillimeve të tjera që nevojiten, në zhvillimin e programeve projektuese (detyrat projektuese) për përgatitjen e Dokumentacioneve Teknike (DT) investuese të projekteve të planifikuara sipas standardeve të aprovuara në BE;
- Udhëzon dhe ndihmon OE të specializuar për marrjen dhe pajisjen me kushte, pëlqim dhe leje të duhura si Komunale ashtu dhe për ato të shërbimeve përcjellëse të domosdoshme për nisjen e realizimit të projekteve;
- Mbështet zyrën e prokurimit në vlerësime dhe raportime gjegjëse në procesin e prokurimit për OE të specializuara në realizimin-ndërtimin e projekteve;
- Bën menaxhimin e projekteve duke i përcjellë me mbikëqyrje financiare, kohore dhe të cilësisë së punëve, materialeve dhe pajisjeve të OE në procesin e realizimit -ndërtimit sipas standardeve të BE-së deri në përmbylljen e projekteve- kur bëhet kontrollimi final inspektues dhe dorëzimi përdoruesve të tyre;
- Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të ndërtimeve të komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit, me pikësynim zhvillimin e ndërtimit me standardet të BE-së;
- Përcjell, merr pjesë dhe angazhohet në mësimin dhe përsosjen profesionale të Vazhdueshme;
- Ruan dokumentacionin dhe arkivon dokumentacionin e saj në kuadër të arkivit të Drejtorisë së Transformimit të Kryeqytetit, dhe më tutje të Komunës;
- Sektorët ndihmojnë njëri tjetrin në rast nevoje me staf;
- Kryen edhe punë tjera që janë në interes të drejtorisë dhe komunës.

2. Sektori i menaxhimit të kontratave

Fushë veprimtaria e Sektorit:

- Asiston në hartimin e planeve dhe programeve zhvillimore afatmesme, vjetore ose edhe mujore për drejtorinë;
- Harton planet dhe programet zhvillimore afatmesme, vjetore ose edhe mujore për sektorin;
- Harton planet projekt e menaxhimit për secilin projekt në fillim të kontratave me OE;
- Përcjell, hulumton dhe asiston në përpilimin e planeve dhe programeve zhvillimore që hartohen prej drejtorive të Komunës në lidhje me projektet e mundshme të Ndërtimit të Lartë, nga aspekti i njohurive teknike dhe të përpilimit sa më të saktë të buxheteve për ato;
- Planifikon kohën me afatet, cilësinë e kërkuar dhe buxhetin për kryerjen e punëve në realizimin e projekteve;
- Përcjell realizimin dhe mbarëvajtjen e punëve ndërtimore dhe zeytare sipas Dokumentacioneve Teknike(DT) investuese, dhe raporton periodikisht me raporte javore, mujore dhe vjetore;
- Mbikëqyrë hartimin e projekteve për investime të komunës, konsultohet me drejtorinë dhe komunitetin për projekte të reja;
- Udhëzon dhe ndihmon OE të specializuar për marrjen dhe pajisjen me kushte, pëlqim dhe leje të duhura si Komunale ashtu dhe për ato të shërbimeve përcjellëse të domosdoshme për nisjen e realizimit të projekteve;
- Mbështet zyrën e prokurimit në vlerësime dhe raportime gjegjëse në procesin e prokurimit për OE të specializuara në realizimin-ndërtimin e projekteve;
- Ben menaxhimin e projekteve duke i përcjellë me mbikëqyrje financiare, kohore dhe të cilësisë së punëve, materialeve dhe pajisjeve të OE në procesin e realizimit -ndërtimit sipas standardeve të BE-së deri në përmbylljen e projekteve- kur bëhet kontrollimi final inspektues dhe dorëzimi përdoruesve të tyre;
- Mbikëqyr realizimin e kontratave për projekte të ndërtimit të lartë (ndërtimet e reja, rikonstruktivet, adaptimet, meremetimet dhe mirëmbajtjen e objekteve);
- Raporton për mbarëvajtjen e kryerjes së fazave të ndërtimit;
- Përgatit njoftimet për vizita të inspektimit dhe të punimit të protokolleve;
- Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të ndërtimeve të komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit, me pikësynim zhvillimin e ndërtimit me standardet të BE-së;
- Përcjell, merr pjesë dhe angazhohet në mësimin dhe përsosjen profesionale të vazhdueshme;
- Ruan dokumentacionin dhe arkivon dokumentacionin e saj në kuadër të arkivit të Drejtorisë së Transformimit të Kryeqytetit, dhe më tutje të Komunës;
- Sektorët ndihmojnë njëri tjetrin në rast nevoje me staf;
- Kryen edhe punë tjera që janë në interes të komunës.

3. Sektori i shërbimeve të përgjithshme

Fushë veprimtaria e Sektorit:

- Asiston në hartimin e planeve dhe programeve zhvillimore afatmesme, vjetore ose edhe mujore për drejtorinë;
- Harton planet dhe programet zhvillimore afatmesme, vjetore ose edhe mujore për sektorin;
- Jep mbështetje nga aspekti juridik, financiar dhe të asistencës sekretarie;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e kontratave nga aspekti juridik dhe financiar;
- Kontrollon, përcjell dhe mbikëqyr se bashku me sektorët gjegjëse realizimin e kontratave dhe në këtë cilësi menaxhon proceset e realizimit të projekteve në përputhshmëri me norma teknike të pranuar në nivel ndërkombëtar dhe nivel të BE-së;
- Shqyrton dhe jep ekspertize për konfliktet që dalin nga kontratat në mënyrë të realizimit sa më të suksesshëm të projekteve;
- Ruan dhe mbron në mënyrë të drejtë pasurinë dhe interesat e Drejtorisë dhe të Komunës në përgjithësi ndaj palëve të treta;
- Harton raporte afatmesme, vjetor, mujore për sektorin;
- Këshillon Drejtorin dhe sektorët tjera nga lëmi e ndërtimit të ultë;
- Raporton për mbarëvajtjen e kryerjes së fazave të ndërtimit;
- Përgatit njoftimet për vizita të inspektimit dhe të punimit të protokolleve;
- Sektorët ndihmojnë njëri tjetrin në rast nevoje me staf;
- Kryen edhe punë tjera që janë në interes të komunës.

V. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit me nr.14.030/01-21504/24 i dt.08.02.2024 dhe e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.

VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave;
- Drejtorisë për Transformim të Kryeqytetit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

